



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 33, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "KASHAR
MASTERPLAN", STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIMESH 5, 12 DHE 22 KATE MBI
TOKË DHE 3 KATE PARKIM NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Stela Konstruksion" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Kashar Masterplan", Strukturë banimi dhe shërbimesh 5, 12 dhe 22 kate mbi tokë dhe 3 kate parkim nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Stela Konstruksion" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 21/02/2025